

# Dhuna shtëpiake

→ Largimi dhe ndalimi i kthimit sipas nenit 43 dhe Ligjeve tjera që vijnë të ligjit policorë

→ Masat mbrojtëse sipas të drejtës civile



# Gewalt.Los

# Përgjigjet në pytjet më të shpeshta

Kjo broshurë ka për qëllim që ti informoj personat që i janë të nënshtruar dhunës shtëpiake për drejtat e tyre. Njëkohësishtë përgjigjen të gjitha pyetjet e përgjithshme gjatë intervenimit në lidhje me dhunën shtëpiake si dhe tregohen mundësitë ekzistuese ose në ndërtim e sipër.

## Largimi dhe ndalimi i kthimit: Neni 43 dhe ligjeve tjera që vijnë ligji policorë

### Kujt i del në mbrojtje ku ligj?

Ky ligj mbron çdo person i cili i nënshtrohet dhunës shtëpiake pa marrë parasysh se dhuna ushtrohet nga bashkëshorti/ja, nga partneri/ja i/e etës, nga prindërit, të afërmit ose nga bahkëjetuesit.

### Ku vlen ky ligj i ri?

Vlen për kantonin e St.Gallenit: Vendëbanimi i personit të prekur nga dhuna duhet të jetë në rajonin e Kantonit të St. Gallenit. Një ligj i ngjashëm ekziston në Kantonin Appenzell Ausserrhoden.

### Çfarë mundë të bëni ju nëse jeni të prekur nga dhuna?

Nëse ju apo fëmija juaj keni pësuar dhunë, atëherë mundeni ti drejtoheni organeve që të ju ndihmojnë. Në raste akute/urgjente duhet menjëherë të kërkonti mbrojtje rrespektivisht të ndihmë nga policia:



## (Telefoni kujdestar) Notruf 117

Policia është e obliguar që të ju ofroj menjëherë ndihmë. Ajo heton çështjen dhe ka të drejtë që personat të cilët janë të rrezikshëm për të tjerët, ti largoj për dhjetë ditë nga banesa / shtëpia dhe nga rrethina dhe tia ndaloj kthimin në këtë rajon. Ju si persona të prekur nga dhuna si dhe fëmijët tuaj parimishtë keni të drejtë të qëndroni edhe më tutje në rrethin tuaj.

Ligji penal përmban delktev të cilat shteti i ndjekë sipas detyrës zyrtare. Në rastet e tilla policia është e obliguar (detyruar) që të hulumtoi rastin pa marrë parasysh dëshirën e viktimës për këtë qështje, të veprimi dhe të hetoi kundër kryesit të veprës në mënyrë që ai të vëhet para organeve të drejtësisë. Përpos kësaj ka poashtu delikte të cilat ndiqen apo hetohen penalisht për t'u vënë para drejtësisë, vetëm me kërkesën e personit të dëmtuar. Kërkesa për ndjekjen e rastit duhet të bëhet brenda tre muajsh, nga kur ka ndodhur vepra dhe duhet të dorëzohet pranë policisë ose gjyqtarit hetues.

Deliktet e rënda, sikurse deliktet e vrasjes, lëndimet e rënda trupore, përdhunimi, shfrytëzimi, privimi nga liria, ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare pavarësisht se në çfarë raporti me njëri tjetrin gjenden viktimat dhe kryesi i veprës. Në vazhden e kësaj vlenë ndjekja sipas detyrës zyrtare edhe për lëndimet e thjeshta trupore, konfliktet fizike dhe kërcënimet por kjo vetëm atëherë nëse veprimi ndodhë në mes të bashkëshortëve deri në një vit pas ndarjes së tyre dhe qifteve në bashkëjetesë (vlenë edhe për qiftet e gjinisë së njëjtë) deri në një vit pasi e ata kanë ndarë banimin e përbashkët. Nëse nuk ka të bëjë me rastin e theksuar më lartë, atëherë për të tri deliktet e cekura, duhet të bëhet kërkesa për ndjek-

jen e rastit në mënyrë që personi i cili ka përdorur dhunën të mund të vihet para organeve të drejtësisë. Veprimet (fizike) të njëhershme, prishja e gjërave në shtëpi, prishja e qetësisë shtëpiake, ngacmimi seksual, keqëpërdorimi i telefonit etj., ndiqen penalisht vetëm me kërkesën e personit të dëmtuar. Dhuna e të rriturve ndaj fëmijëve ndiqet në parim penalisht sipas detyrës zyrtare.

### **Çfarë mund të bëni nëse vëreni dhunën në fqinjësi?**

Edhe në këtë rast mund të drejtoheni policisë.

### **A mvaret largimi nga dëshira e viktimës?**

Jo, nës ekziston një rrezik serioz dhe viktima nga friga prej kërcënimeve të fshehura nuk e dëshiron largimin, policia mundet prapëseprap të urdhëroj largimin. Ligjdhënësi dëshiron kështu sipas detyrës ti ndihmoj viktimat e dhunës.

### **A luajnë rol pronësia e banesës apo mardhënja e qirasë?**

Jo, ato nuk luajnë rol fare. Policia mundet çdo person që sjellë rrezik edhe nëse është pronarë i banesës ose qiramarrës i vetëm ta largojë nga banesa/shtëpia.

### **Marrja e çelësave, dhënja e adresës për dërgesat gjyqësore**

Policia ia merr personit i cili ushtron dhunë, me rastin e largimit nga banesa çelësat e banesës ose të shtëpisë. Nga personi i larguar policia kërkon që ai të jep një adresë në të cilën mund të dërgohen shkrinat zyrtare.

### **Çfarë guxon të marrë me vehte personi i larguar nga banesa/shtëpia?**

Personi në fjalë guxon të marrë me vehte gjërat më të rëndësishme për nevojat personale (p.sh. dokumenta personale, rroba, barëra/medikamente e kështu me radhë).

### **Për cilën fushë vlen ndalimi i kthimit në banesë/shtëpi?**

Kjo masë vlenë për banesën/shtëpinë si dhe për rrethinën e ngushtë. Kësaj i takojnë p.sh. hyrjet, shkallët e shtëpisë, podrumi, dhoma për larjen e rrobave, oborri, kopshti dhe rrugët hyrëse të banesës/shtëpisë. Gjatë marrjes së vendimit për masat mbrojtëse, vendimtare është një mbrojtje e viktimës me ndikim të plotë si dhe pengimi i eskalimit të sërishtëm të dhunës. Policia është e detyruar në vendimin për largim që të shënojë kuartë rrethin mbrojtës. Personi i larguar e merr një vendim me shkrim për largim nga banesa/shtëpia, ndërsa personi i rrezikuar një kopje të saj.

### **Çfarë ndodhë nëse personi që ushtron dhunë nuk largohet me vetëdëshirë?**

Në këtë rastë policia ka të drejtë të përdorë dhunën dhe ta largoj personin që ka ushtruar dhunë.

### **A mundet që largimi apo ndalimi për kthim në banesë/shtëpi të shqiptohet nëse policia kupton më vonë për ushtrimin e dhunës?**

Po. Një largim me ndalim kthimi mundet edhe atëherë të shqiptohet nëse personi i prekur nga dhuna pas keqëtrajttimeve i drejtohet policisë dhe ka frigë nga dhuna e metutjeshme.

### **Sa mund të zgjasë ndalimi i kthimit?**

Ndalimi i kthimit në banesë/shtëpi vlenë dhjetë ditë. Mbrenda tri ditësh ky vendim duhet verifikuar dhe lejuar nga gjykatësi. Ky vendim është përfundimtar. Nëse pason heqja e vendimit të ndjekjes nga ana e policisë, atëherë kjo ka për pasojë atë që personit të marrur

në fjalë i kthehet qelësi i banesës/shtëpisë dhe mund të kthehet aty. Për këtë paraprakisht informohet viktimja.

### **A mund të zgjatet vendimi për ndalimin e kthimit në banesë/shtëpi?**

Po. Nëse ndalimi për kthim në banesë/shtëpi duhet të zgjasë më shumë se dhjetë ditë, atëherë duhet që personi i rrezikuar mbrenda afatit prej shtatë ditësh nga largimi të drejtohet gjyqit civil (Zivilgericht) për të vendosë masa mbrojtëse (vgl. Me sa vijon: "Vazhdimi i mbrojtjes: Vendosija e masave mbrojtëse nga gjyqi civil").

### **Si kontrollohet zbatimi i ndalimit për kthim në banesë/shtëpi?**

Zbatimii ndalimit për kthim parimishtë verifikohet nga policia vetëm nëse personi i rrezikuar e kërkon një gjë të tillë. Policia ka të drejtë që vetvetiu të kontrolloj zbatimin e ndalimit për kthim në banesë/shtëpi. Këtë e bënë policia para së gjithash nëse ajo vlerëson se ekziston një rrezik i shtuar i eskalimit të sërishëm të shunës.

### **Çfarë mund të bëni ju nëse personi i larguar nga banesa/shtëpia nuk i përmbahet ndalimit për kthim në banesë/shtëpi?**

Në këtë rastë duhet që menjëherë të lajmëroni policinë (Telefoni kujdestar, Notruf 117). Policia nëse ka nevojë e largon personin në fjalë edhe me detyrim/dhunë. Hyrja/kthimi në banesë/shtëpi paraqet vepër të sanksionuar me ligj (i padëgjueshëm ndaj vendimit të organeve) dhe do të dënohet me arrestim ose dënim me të holla.

### **A ka të drejtë të vijë sërishë personi i larguar nga banesa/shtëpi a nëse ai është qetësuar sërishë?**

Jo. Derisa vendimi për largimin e tij nga banesa/shtëpia është i plotëfuqishëm, personi i larguar nuk guxon të kthehet. Edhe nëse personi i rrezikuar e lejon me vetëdëshirë të kthehet në banesë/shtëpi, personi i larguar bënë vepër të sanksionuar me ligj. Nëse personi i larguar nga banesa/shtëpia është i detyruar urgjent që të marrë gjëra nga banesa, atëherë këtë guxon ta bëjë vetëm në prani të një polici/e.

### **Ku mund të informoheni ose të këshilloheni?**

Për këshillimin të personave të prekur nga dhuna është në dispozim:

Këshillimorja për gratë e goditura nga dhuna

Qendër profesioanle e për ndihmë vktimave

**Beratungsstelle Gewaltbetroffene Frauen**

**Fachstelle der Stiftung Opferhilfe**

**Telefon 071 227 11 44**

Këshillimorja për ndihmë viktimave

Qendër profesioanle e për ndihmë vktimave

**Beratungsstelle Opferhilfe**

**Fachstelle der Stiftung Opferhilfe**

**Telefon 071 227 11 00**

(für gewaltbetroffene Männer / për meshkujt e prekur nga dhuna)

Kjo këshillimore ju informon, ndihmon dhe këshillon në pytjet e juja personale dhe në pyetjet në lidhje me të drejtat e juaja. Ajo ju ndihmon për të ushtruar kërkesën për masa mbrojtëse pranë gjykatës civile. Këshillimi është falas. Bashkëpunëtorët/et i janë të nënshtruar rreptësishtë obligimit për të heshtur. Ju keni të drejtë që në çdo kohë të ndërpreni këshillimin.

## **A dëshironi ju që qendra për këshillim ndihmë viktimave (Beratungsstelle Opferhilfe) të merr kontakt me ju?**

Atëherë jeni të detyruar që të autorizoni me shkrim policinë për ti dërguar më tutje shënimet personale qendrës për këshillim ndihmë viktimave (Beratungsstelle Opferhilfe) përmes (Formularit "Übermittlung nach Neni 6 Abs. 2 OHG, Intervention gegen Häusliche Gewalt). Në këtë rastë këshillimorja merr kontakt me ju. Ju mundeni edhe më vonë ti drejtoheni kësaj këshillimore vetvetiu.

## **Ku mundë të këshillohet personi i larguar nga banesa/shtëpia?**

Personi i larguar mundë të drejtohet në "Këshillimi i meshkujve gjatë dhunës", "Männerberatung bei Gewalt". Kjo i është bashkangjitur ndihmës për mbrojtje (shiko adresën). Aty iu ofrohen informata, këshillime dhe ndihmë falas.

Nëse personi që ushtron dhunë dëshiron që të ndërroj sjelljen e tijë, atëherë ai mundet të drejtohet për këshillim në këshillimoren "cib" ose në këshillimoren "Meshkujt kundër dhunës së meshkujve", "Männer gegen Männer-Gewalt" në St.Gallen (shiko adresën). Këtë këshillim duhet paguar vehtë.

Poashtu ekziston mundësia për pjesëmarrje në një plan social për mësim/edukim pas sqarimeve të bëra. Ky program udhëhiqet nga ndihma për mbrojtje "Bewährungshilfe"

## **Informata të autoriteteve për kujdestari "Vormundschaftsbehörde"**

Nëse vien masat e kujdestarisë në shprehje, atëherë policia i lajmëron sa më shpejtë që është e mundur autoritetet për kujdestari "Vormundschaftsbehörde" për largimin e personit në fjalë nga banesa/shtëpia. Autoritetet e kujdestarisë "Vormundschaftsbehörde" verifikojnë se a duhet zaptuar masa kujdestarie ndaj personit të larguar nga banesa/shtëpia. Nës fëmijët janë të prekur nga dhuna, ajo sqaron se a janë të nevojshme masat mbrojtëse për fëmijë.

# **Mbajtja në polici sipas Nenit 40 dhe ligjeve tjera që vijojnë të ligjit policorë**

## **A ka Policia të drejtë që një person i cili ushtron dhunë ta marr në arrest?**

Parimishtë po. Policia mundë të marrë një person përkohësishtë në arrest, nëse ai e kërcënon vehten apo të tjerët dhe ky kërcënim nuk mundet ndryshe të evitohet. Shpesh mjaftojnë masat më te buta për largimin nga banesa/shtëpia dhe ndalimi për kthim për ta larguar rrezikun ose së paku për ta zvogluar ate. Zakonishtë masën për largim nga banesa/shtëpia në rastë të dhunës shtëpiake e shqipton Policia. Në arrest policor do të merret ai person që është i gatshëm për ushtrim të dhunës dhe është nën ndikim të alkoolit apo të drogës ose nëse e përsërit ushtrimin e dhunës apo len të kuptoj se vendimin për largim nga banesa/shtëpia me ndalim kthimi nuk do ta zbatoj.

## **Sa kohë mundet policia të mbajë një person në arrest?**

Personi nuk guxon të mbahet në arrest më gjatë se sa që është e nevojshme. Në rastë rreziku për të rrezikuar vehten, mbajtja në arrest mundet të zgjasë më së shumti 24 orë. Në rastë të rrezikimit të personave tjerë, mbajtja në arrestë mundë të zgjatet nga gjykatësi me kërkesën e policisë më së shumti për tetë ditë.

## **A munden që vendimi për marrje në arrest dhe për largimin nga banesa/shtëpia me ndalim kthimi të mirren njëkohësishtë?**

Po. Edhe nëse personi që ushtron dhunë mirret në arrest policorë, policia ka të drejtë të marrë vendimin për largim nga banesa/shtëpia me ndalim kthimi, pasi që vendimi për arrest mund të mirret vetëm për një kohë të shkurtër. Në këtë rastë ndalimi për kthim në banesë/shtëpi është shumë i rëndësishëm, pasi që kthimi në banesën e përbashkët qon shpesh deri te eskalimi i sërishëm i dhunës. Personi i prekur nga dhuna duhet që i pa shqetësuar fare të vendosë se a dëshiron që pranë gjyqit civil të kërkoj sjelljen e masave mbrojtëse.

## **Raporti në mes burgut hetues dhe largimit nga banesa/shtëpia**

Se personi që ushtron dhunë a do të mbahet pas arrestit në burg hetues apo jo mvaret para së gjithash nga ajo, se a do të ngritet procedurë penale, apo ekzistojnë arsye të forta për të sjellë vendimin për burgim hetues.

# **Zbatimi i mbrojtjes: Lëshimi i urdhërave për masa mbrojtëse përmes gjyqit civil: Neni 43<sup>quinquies</sup> ligji policorë**

Nëse dëshironi që ndalimi për kthim të zgjasë më shumë se dhjetë ditë, atëherë duhet që të veproni dhe mbrenda shtatë dite prej largimit pranë gjyqit civil të bëni kërkesën për urdhërimin e masave mbrojtëse. Në këtë rastë ndalimi për kthim zgjatet automatikisht më së shumti për dhjetë ditë, ashtu që gjykata të ketë kohë për të vendosur në lidhje me lutjet tuaja. Gjyqi e lajmëron menjëherë policinë për arritjen e kërkesës suaj. Policia e lajmëron personin në fjalë për vazhdimin e masave. Një kërkesë për urdhërimin e masave mbrojtëse mund të ushtrohet edhe pa intervenimin paraprak të policisë. Se cilat masa mbrojtëse i kërkon mvaret nga ajo se a jeni të martuar apo jo.

## **Si mund të ushtroni lutje për masa mbrojtëse sipas të drejtës civile nëse ju jeni të martuar me personin e larguar nga banesa/shtëpia?**

Në këtë rastë jeni të detyruar që sa më shpejtë, mirëpo më së voni mbrenda shtatë dite pas largimit të ushtroni kërkesën përmes gjykatës për mbrojtjen e bashkëshortësisë, pranë gjykatës përgjegjëse, për lëshimin e masave mbrojtëse të bashkëshortësisë. Nëse është e hapur procedura e shkurorëzimit pranë gjykatës, atëherë keni të drejtë të bëni lutjen për masa parandaluese. Është e rëndësishme që paraprakishtë të këshilloheni, në mënyrë që të ushtroni lutje të drejta dhe të dorëzoni dokumentet dhe dëshmit e nevojshme. Këshillimorja ndihmë viktimave "Beratungsstelle Opferhilfe" në St.Gallen ju ndihmon për bërjen e lutjes. Ajo mund të vlerësoj se a ju duhet ndihma e avokatit apo jo.

## **Cilat lutje/kërkesa mund të shtrohen?**

- Mbajtja e banesës/shtëpisë që është pronë e dy bashkëshortëve
- Ndalimi i hyrjes në banesë/shtëpi dhe afrimi në atë rrethinë
- Masat si ndalim kontakti apo ndalim i afrimit në rrugën ku jetoni, lagje etj.
- Caktimi i të drejtës për mbikqyrjen e fëmijëve
- Rregullimi i të drejtës së vizitës
- Caktimi i shumës së nevojshme për përkujdesjen e fëmijëve dhe eventualementisht caktimi i shumës për përkujdesjen e bashkëshortit/es

- Caktimi i gjërave të posaçme, urdhëresa për ndarjen e gjërave etj.
- Udhëheqja e procesit falas/parapagimi për proces gjyqësor
- Lutje/kërkesa si p.sh për urdhëresa urgjente, marrje në pyetje ndaras etj.

### **A luajnë rol mardhënia e qirasë apo pronësia e banesës/shtëpisë?**

Jo, këto nuk luajnë rol fare. Banesa/shtëpia mundë të ju caktohet juve edhe nëse bashkëshorti/ja është pronar apo qiramarrës i vetëm. E vetmja gjë që është e rëndësishme që personi i rrezikuar të ketë nevojë urgjente për banim.

### **Si mundë të dëshmohet dhuna?**

Për dëshmimin e dhunës duhet sjellë dëshmi: Urdhëresa e policisë dhe vendimi i gjyqtarit për lejimin e arrestit, eventualishtë aktëgjykime, raporte të policisë për raste të mëherëshme, dëshmi të mjekut, fotografi për lëndimet e shkaktuara, shkresa kërcënuese të palës tjetër, informata me shkrim të këshillimoreve ose të shtëpive të grave, vetëm në raste të jashtëzakonshme shënime për dëshmitarët nga rrethi i të afërmëve apo të të njohurve (me adresë dhe shënime për temën e dëshmisë), mirëpo jo edhe raporte me shkrim të personave privat.

### **A do të mirret në pyetje personi i larguar nga banesa/shtëpia në lidhje me lutjet/kërkesat tuaja?**

Parimishtë po. Personi i larguar ka të drejtë të tregojë ngjarjen sipas këndvështrimit të tij, të bëjë lutje/kërkesa të veta dhe të dorëzojë dëshmi. Gjykata zakonishtë vendosë pas marrjes në pyetje të të dy palëve.

### **Çfarë janë urdhëresat urgjente?**

Duke e marrë parasyshë urgjencën e kohës, gjykata ka të drejtë gjatë zgjatjes së procesit edhe pa e marrë në pyetje palën kundërshtarë të lëshoj urdhëresa të përkoishme. P.sh. mundë të vendosë që banesa edhe më tutje ti caktohet personit të rrezikuar dhe që edhe më tutje të vlejë ndalimi për hyrje në te. Para vendimit definitiv, personi i larguar nga banesa/shtëpia do ta ketë mundësinë e thënies së mendimit të tij. Këshillohet që sa i përketë ndarjes, caktimit të banesës dhe ndalimit për hyrje në te, të ushtrohet kërkesa për një urdhëresë urgjente.

### **A do të konfrontoheni ju me personin e larguar nga banesa/shtëpia gjatë procesit gjyqësorë?**

Gjykata i fton të dy palët për një shqyrtim gojor. Nëse ju nuk jeni në gjendje që për shkaqe psikike të takoni partnerin, atëherë këshillohet që të bëni lutjen për marrje në pyetje ndaras për të parandaluar një konfrontim direkt. Në raste të veçanta kjo ju mundësohet me dëshminë e mjekut.

### **A keni të drejtë që të shoqëroheni në ditën e gjykimit?**

Një bashkëpuntore e këshillimores mundë të ju shoqëroj gjatë proceseve gjyqësore. Gjykata duhet paraprakishtë të informohet. Gjatë termineve për marrje në pyetje nuk keni të drejtë shoqërimi. Nuk mundë të shoqëroheni edhe nga një avokate. Në raste të jashtëzakonshme gjykata ka mundësi të lejoj të shoqëroheni nëse ju jeni në gjendje ta arsyetoni këtë.



## **Çfarë ndodhë me shpenzimet e gjykatës dhe eventualisht me shpenzimet e avokatëve?**

Shpenzimet e gjykatës dhe të avokatëve parimishtë ndahen sipas parimit të fituesit apo të humbësit, pra mvaret nga ajo se se si kaloni para gjykatës me kërkesat tuaja. Nëse një person ka nevojë, d.m.th. nuk ka të ardhura apo pasuri të mjaftueshme ka të drejtë të kërkojë një parapagim nga pala kundërshtarë nëse ai/ajo është në gjendje që të paguaj. Përndryshe duhet shtruar një kërkesë për një proces gjyqësor pa shpenzime/falas. Në rastë nevojë këshillohet që të dy kërkesat ti lidhni dhe ti ushtroni sa më herët që është e mundur.

## **Çfarë mundë të bëni nëse personi i larguar nga banesa/shtëpia nuk i zbaton/rrespekton urdhëresat/ndalesat e vendosura nga gjyqi?**

Thirrni menjëherë policinë duke i përmendur vendimet e gjyqit. Vendimet duhet ti ruani mirë. Policia e largon të padëgjueshmin dhe e paditë pranë gjykatës hetuese për padëgjueshmëri ndaj vendimeve të enteve. Policia ka të drejtë të padëgjueshmin përkohësishtë ta mbajë në arrest, nëse ekziston një rrezik akut dhe ky rrezik nuk mundet në mënyrë tjetër të evitohet.

## **Sie e ushtroni kërkesën për masa mbrojtëse sipas të drejtës civile nëse nuk jeni të martuar me personin e larguar nga banesa/shtëpia?**

Në këtë rastë situata është aq e komplikuar sa që një këshillim është më se i nevojshëm. Parimishtë ju keni të drejtë ti drejtoheni gjykatësit të gjykatës përgjegjëse me kërkesë për mbrojtje të shpejtë dhe të kërkonin ndalesën për të hyrë në banesë apo edhe masa tjera të nevojshme për mbrojtje. Për çështjen e fëmijëve nuk është gjykata përgjegjëse porë autoritetet për përkujdesje (Vormundschaftsbehörde).

## **Keni kujdes ndaj sigurisë suaj!**

**Rregullat e reja ligjore për largim nga banesa/shtëpia i ofrojnë më shumë mbrojtje personit të prekur dhe para së gjithash ofrojnë mundësinë për të mbetur edhe më tutje në rrethin tuaj të mëpars-hëm. Këto masa nuk ofrojnë mbrojtje të sigurtë nga dhuna! Në rastë të rrezikshme mundë të jetë e rëndësishme që ju edhe fëmijët tuaj prapëseprapë ta lëshoni banesën dhe të kërkonin banim të sigurtë (P.sh. shtëpi të grave), së paku deri sa të kaloj koha më e rrezikshme. Në kohën e ndarjes dhe të shkurorëzimit aktet e dhunës vijnë duke u shtuar! Ja disa faktorë që e shtojnë rrezikun: Pronësia e armëve, konsumimi i alkoolit apo drogës, kërcënimet (kërcënimet edhe me vetëvrasje) apo edhe xhelozia e tepruar, si dhe mendimi për të shfrytëzuar tjetrin si pronë të tijë. Lirimi nga një mardhënie me keqtrajtime është i mundimshëm dhe shpesh edhe i gjatë. Ju duhet që patjetër të organizoni ndihmë dhe të ndërtoni rrjetin ndihmës.**





# Karta emergjente

**Në rastë të dhunës në bashkëshortësi, partneritet dhe familje**

**Nuk e ndieni vehten të sigurtë në lidhjen që e keni?**

A ushtrohet dhunë ndaj jush apo ndiheni të kërcënuar?

**Dhuna shtëpiake nuk është problem privat!**

**Për këtë ka ndihmë dhe përkrahje**

**Për raste urgjente dhe ndihmë të menjëhershme:**

**Thirrja emergjente në polici**



<b>Gjykatat e qarkut:</b>	St.Gallen	<b>071 228 46 00</b>
	Rorschach	<b>071 846 82 50</b>
	Rheintal, Altstätten	<b>071 757 83 00</b>
	Werdenberg-Sargans, Mels	<b>081 720 00 50</b>
	Gaster-See, Uznach	<b>055 285 91 30</b>
	Ober- + Neutoggenb., Lichtenst.	<b>071 988 40 33</b>
	Alltogggenburg-Wil, Wil	<b>071 913 91 61</b>
	Untertogggenburg-Gossau, Flawil	<b>071 394 18 18</b>


Nëse ju duhet këshillim apo përkrahje në raste dhune, nëse nuk e dini se si duhet ushtruar kërkesën pranë gjykatës civile për masa mbrojtëse në mënyrë që të vazhdohet mbrojtja, atëherë drejtohuni në

**Beratungsstelle Gewaltbetroffene Frauen**

**Fachstelle der Stiftung Opferhilfe**

(Këshillimorja për gratë e goditura nga dhuna)

Teufenerstrasse 11, 9001 St.Gallen




**Beratungsstelle Opferhilfe**

**Fachstelle der Stiftung Opferhilfe**

(Këshillimorja për ndihmë viktimave)

(für gewaltbetroffene Männer – për meshkujt e prekur nga dhuna)

Teufenerstrasse 11, 9001 St.Gallen



Paralaajmërimi me telefon i dëshirueshëm

Nëse janë edhe fëmijët e prekur, atëherë drejtohuni qendrave që vijojnë administratës komunale (Gemeindeverwaltung)

Nëse fëmijët dhe të rinjët janë direkt të prekur nga dhuna

**Kinderschutzzentrum InVia**

(Qendra për mbrojtjen e fëmijëve)

Falkensteinstrasse 84, 9006 St.Gallen

**071 243 78 02**

Ose nëse ju duhet mbrojtje urgjente dhe siguri lajmëroheni në Schlupfhus, qendra për mbrojtjen e fëmijëve

**Kinderschutzzentrum Schlupfhuus**

Claudiusstrasse 6, 9006 St.Gallen

**071 243 78 30**

Nëse ju dhe fëmijët tuaj duhet strehuar në vendë të sigurtë dhe nëse keni nevojë për këshillim dhe përkrahje:

**Frauenhaus St.Gallen** (Shtëpia e grave)

Mundë të thirrni non stop

**071 250 03 45**



Nëse ndaj jush është ushtruar dhunë trupore, duhet që të kërkonti ndihmën mjekësore dhe të merrni një dëshmi të mjekut. Për këtë shkoni te mjeku/mjekja juaj

Tel.....

Në raste urgjente mundë të kuptoni se cili mjek është në shërbim (kujdestar) përmes

Tel. 144

Nëse ndaj jush është ushtruar dhunë seksuale, keni mundësi që mbrenda 3 ditëve pas aktit (non stop) të merrni ndihmë të menjëherëshme për gratë e dhunuara

**Soforthilfe für vergewaltigte Frauen** 079 698 95 02  
(Ndihmë e menjëherëshme për gratë e dhunuara)

pranë spitalit kantonal të St.Gallenit. Atje ju ofrohet përkrahje dhe ndihmë mjekësore. Lëndimet mundë të mjekohen dhe sëmurjet të parandalohen. Një kontrollim nga mjekët e mjekësisë ligjore e cila është e rëndësishme për një padi të mëvonshme poashtu mundë të bëhet këtu.

Nëse ekzistojnë pasione (p.sh alkooli) ose ju duhet përkrahje tjetër (p.sh. probleme për edukim), atëherë drejtohuni në

**Qendrën për këshillim social të regjionit tuaj**  
(Sozialberatungsstelle Ihrer Region)

Adresën e gjeni në librin e telefonit ose në entin social të komunës suaj **das Sozialamt Ihrer Gemeinde**. Atje mundë të drejtoheni edhe nëse keni vështirësi financiare përmes ndarjes nga partneri/ja.

Informatat për grupe që ndihmojnë vetvehten, p.sh në lëminë e pasioneve mundë ti merrni në qendrën kontaktuese për grupe që ndihmojnë vetvehten:

**Kontaktstelle für Selbsthilfegruppen** 071 222 22 63  
www.selbsthilfe-gruppen.ch

Personat të cilët janë larguar nga policia dhe u është shqiptuar ndalesa për kthim mundë të marrin informata dhe këshillimin e parë falas në:

**Beratungsstelle Häusliche Gewalt** 071 229 26 30  
**für gewaltausübende Personen**  
(Këshillimorja, dhuna shtëpiake për personat të cilët përdorin dhunën)  
Oberer Graben 22, 9001 St.Gallen

**Männer gegen Männer-Gewalt** 071 22 333 11  
(Meshkujt kundër dhunës së meshkujve)  
Vadianstrasse 40, 9000 St.Gallen,  
ostschweiz@gewaltberatung.org

**Dhuna ndaj grave dhe fëmijëve nuk është problem privat**



Koordinationsstelle des Kantons St.Gallen  
gegen häusliche Gewalt  
Oberer Graben 32, 9001 St.Gallen, Tel. 071 229 75 43